

“Mbështetje për sigurinë e ushqimit, standardet veterinare dhe fitosanitare”

“Mbështetje për sigurinë e ushqimit, standardet veterinare dhe fitosanitare” është një projekt i financuar nga BE, i zbatuar nga një grup organizatash të kryesuara nga Autoriteti i Sigurisë Ushqimore të Irlandës (FSAI). Grupi zbatues përfshin gjithashtu edhe Autoritetin e Sigurisë Ushqimore të Finlandës, Departamentin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Marinës të Irlandës, si dhe CBS Creative Business Solutions - një OJQ shqiptare. Projekti ka një buxhet total prej 4,998,058 Euro dhe një kohëzgjatje prej 48 muajsh, në një periudhë pune nga 14 janar 2019 deri më 13 janar 2023.

Ky projekt ka për qëllim të forcojë më tej kuadrin ligjor, organizimin, kapacitetin e zbatimit dhe procedurat për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve në mënyrë që të jetë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe përafrimin e Shqipërisë me standartet e BE.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është *"të kontribuojë në rritjen e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve në çdo fazë të procesit të prodhimit të ushqimit, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe administrative në përputhje me axhendën e përgjithshme të reformës së administratës publike"*.

Ky objektivi ndihmon për të komunikuar fushëveprimin e projektit dhe rëndësinë e sigurisë ushqimore në kontekstin më të gjerë të ndikimit pozitiv që mund të ketë mbi ekonominë dhe mjedisin.

Objektivi i përgjithshëm do të arrihet nëpërmjet objektivave specifike të mëposhtme:

Objektivi specifik 1: "Të ndihmojë ristrukturimin e strukturave administrative përkatëse dhe të sigurojë ndërtimin e kapaciteteve të duhura për të zbatuar masat e politikave dhe arkivimin e objektivave strategjike në përputhje me përpjekjet e reformave të përgjithshme të administratës publike dhe kërkesat e anëtarësimit në BE".

Objektivi specifik 2: "Të rritet ndërgjegjësimi publik për të siguruar që konsumatorët të informohen në mënyrë adekuate rreth zgjedhjeve, roleve, përgjegjësi dhe gjithnjë e më shumë të kërkojnë produkte ushqimore të sigurta dhe me cilësi të lartë".

Objektivi specifik 3: "Të ndihmojë në zhvillimin e kornizës së nevojshme ligjore dhe institucionale dhe të hartojë dhe të zbatojë masat e nevojshme politike për të siguruar përparim drejt objektivave strategjike në fushën e sigurisë ushqimore, standardeve veterinare dhe fitosanitare".

Zyra e Projektit: Rruga “Mustafa Matohiti”, nr. 4, Kati IV, Tiranë



Përfituesit kryesorë dhe të tjerë të projektit:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit; Konsumatorët dhe organizatat e tyre përfaqësuese; fermerët, prodhuesit, operatorët e ushqimit, prodhuesit / importuesit e ushqimit të kafshëve; Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe institucionet tjera arsimore dhe kërkimore; Instituti i Shëndetit Publik; Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore; Shërbimi i Ekstensionit; Bashkitë.

Përditësime:

- Per kete projekt komiteti i parë drejtues u mbajt më 20 qershor 2019.
- Katërmbëdhjetë zyrtarë shqiptarë të sigurisë ushqimore morën pjesë në një trajnim një-javor në zyrat qendrore të Autoritetit Irlandez të Sigurisë Ushqimore (FSAI), me datë nisje 21 tetor 2019.



CBS Office, "Mustafa Matohiti" Street, No. 4, IV floor, Tirana, Albania

